



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.987 Prot.

Tiranë, më 29/06/ 2021

V E N D I M

Nr. 116 , Datë 29 /06/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.57 Regjistri, datë 06.04.2021, paraqitur nga R.S, kundër Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjuhës, shtetësisë, gjendjes arsimore dhe vendbanimit*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja R.S, ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, me pretendimin se është diskriminuar nga MASR, në aplikimin që ajo ka bërë në muajin gusht 2019, për të përfituar bursë nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer për vitin akademik 2019-2020.

Ankuesja ka kryer studimet në ciklin e parë të studimeve në Universitetin Napier të Edinburgut, në Mbretërinë e Bashkuar, në programin 4 vjeçar, 240 ECTS në Gjuhë dhe Menaxhim Marketingu. Njohja dhe konvertimi i kësaj diplome nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, në vitin 2012 nuk është shoqëruar me konvertim note. Ankuesja deklaroi se për shkak të rezultateve dhe krediteve të marra, diploma që ajo ka marrë është një diplomë “Honours”. Universiteti i Oxfordit ka bërë konvertimin e çertifikatës së nderit e cila sipas ankueses barazohet me notë US 3.55 US GPA. Sipas ankueses diploma e saj është një Diplomë Bachelor With Second Class Honours.

Ankuesja deklaroi se, ajo kishte arritur të pranohej në dy nga universitetet më të mira në botë sipas *Times Higher Education*, ku bazohet edhe vetë Ministria e Arsimit, atë të Cambridge University dhe Oxford University. Ankuesja shpjegoi se, para se të kryente aplikimin, është interesuar pranë MASR, në lidhje me procedurat e konvertimit të diplomës së saj Britanike, që

ishite njehsuar, por pa konvertim note. Sipas shpjegimeve që ka marrë në atë kohë nga z. I.S, specialist, në Sektorin e Zhvillimit të Programeve të Kërkimit Shkencor, pranë MASR, ajo është informuar se MASR, i kërkon universiteteve të bëjnë vetë konvertimin e diplomës në sistemin Amerikan, pasi këto universitete janë në 15 më të mirat në botë dhe konvertimi i tyre merret seriozisht si bazë. Në datën 04 korrik 2019, punonjësi i ministrisë i ka vendosur në dispozicion ankueses tabelën e konvertimit (Amerikan/Shqiptar)

Ankuesja deklaroi se, në funksion të aplikimit të saj mblodhi një sërë dokumentash për informacion mbi konvertimin e notave Britanike në sistemin Amerikan, duke menduar se kjo ishte mënyra se si vepronte MASR. Në këto dokumenta ankuesja ka përfshirë Komisionin Britaniko- Amerikan, disa universitete të tjera, si dhe konvertimin që kishte bërë vetë Oxford, në përgjigje të kërkesës zyrtare nga ministria për të konvertuar notën Britanike të ankueses në sistemin Amerikan. Sipas përgjigjes së Oxford, First Class UK është e barabartë me 3.7 Amerikane. Oxford gjithashtu ka konvertuar se, nota Britanike e ankueses është 3.55 Amerikane. Megjithë përpjekjet për të marrë një konfirmim nga MASR për konvertimin e notës së saj Britanike në atë Shqiptare, përgjigja që ajo ka marrë është se, një proces i tillë do të bëhej vetëm në momentin që do të hapeshin aplikimet për Master, në Fondin e Ekselencës (1 gusht 2019), ndërkohë që sipas ankueses MASR është një organ që konverton notat gjatë gjithë vitit pavarësisht fondit të ekselencës. Me qëllim që të ruante vendin e Masterit në Cambridge University, ankuesja deklaroi se ka kryer në muajin korrik 2019, një parapagesë prej 10 000 pound Britanik.

Ankuesja shpjegon se, në datën 6 gusht 2019, është mbledhur Komisioni për të shqyrtuar aplikimin dhe pas mbledhjes ajo është njoftuar nga Kryetari i Komisionit se, Komisioni dëshiron që konvertimin e diplomës së ankueses, t'a bëjë Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). QSHA arriti në përfundimin se nota 3.55 Amerikane është 9.59 Shqiptare. Këtë përfundim, QSHA ia komunikoi me email Komisionit. Sipas ankueses, Komisioni prej 4 anëtarësh, votoi me 3 vota pro dhe 1 kundër. Sipas ankueses e-mailet e votimit pro u dërguan te të gjithë anëtarët e Komisionit, si dhe te znj.E.L, sekretare e z.R.Sh, Kryetar i Komisionit. Ndërkohë që aplikantë të tjerë shqyrtoheshin nga Komisioni, përfshirë këtu edhe aplikantë që nuk ishin pranuar nga 15 universitetet më të mira në botë siç kërkon VKM-ja, çështja e ankueses ishte lënë pezull.

Në vijim ankuesja deklaroi se, MASR, i kërkon ndihmë Agjencisë “E&B Consultancy”, si ekspert mbi sistemin britanik, mbi konvertimin e notës së ankueses, e cila i vendos në dispozicion ministrisë tabelën e konvertimit që ata përdornin me universitetet Britanike. Më pas ankuesja, shpjegon se, i është drejtuar Ambasadës së Shqipërisë në Londër, e cila me *e-mail* zyrtar, vuri në dispozicion të MASR informacion të detajuar në lidhje me sistemin e arsimit të lartë në Mbretërinë e Bashkuar dhe konvertoi notën sipas të dhënave të Oxford-it dhe mesatarja doli e njëjtë me atë të QSHA-së dhe konsulentit privat. Pas kësaj, ankuesja deklaroi se i është drejtuar me *e-mail* Ambasadës Britanike në Tiranë. Kjo e fundit nëpërmjet

e-mailit, i konfirmon MASR se, konvertimi i bërë nga Ambasada e Shqipërisë në Londër ishte i saktë. Më pas Ambasada Britanike në Tiranë konfirmoi qëndrimin e saj edhe me shkresë.

Ankuesja deklaroi se, për shkak të zvarritjeve asaj i kishte kaluar afati për në Cambridge University dhe në këto kushte i mbetej vetëm oferta në Oxford University. Nga interesimi që ankuesja bëri pranë ministrisë, u informua se, nga ana e Kryetarit të Komisionit ishte përgatitur një memo më datë 26.08.2019, por një dokument të tillë Shefja e Kabinetit nuk e kalonte tek ministrja. Në datën 22 gusht 2019, ankuesja shpjegon se, është njoftuar me *e-mail* nga Ministria e Arsimit, znj. Besa Shahini se ajo nuk ishte fituese për arsye të precedentit, pa u referuar aspak tek dokumentacioni që ankuesja kishte dorëzuar. Me anë të këtij *e-mail*, ministrja, gjithashtu i komunikoi ankueses se, nuk ka fond për çdo aplikant, ndërkohë që sipas ankueses në VKM nr.483, datë 16.07.2014, nuk ekzistonte një fond tavan, kalimi i të cilit nuk lejohet, përkundrazi është përcaktuar një fond dysHEME, prej jo më pak se 150 000 000 lekë në vit.

Në datën 29.08.2019, ankuesja deklaroi se, MASR ndryshon Kryetarin e Komisionit, duke hequr z. R.Sh dhe duke emëruar Kryetar të Komisionit, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë. Në datën 02.09.2019, mbledhet një Komision i ri, cili vendos se ankuesja nuk është fituese e Fondit të Ekselencës për arsye të precedentit, duke mos i dhënë asnjë arsye se përse dokumentacioni i paraqitur prej saj nuk është marrë për bazë. Këtë vendim/letër, ankuesja deklaroi se nuk e ka marrë dhe është njohur me të kur ky dokument është paraqitur në gjykatë. Sipas ankueses, vendimi i Komisionit Përzgjedhës për programin e ekselencës, zbardhur me procesverbalin nr.7, datë 02.09.2019, është i paligjshëm pasi sipas këtij procesverbali. Komisioni është mbledhur dhe ka marrë vendim në datë 30.08.2019, ora 12:00, vendim i cili në fakt i është komunikuar që në datë 22.08.2019, pasi me *e-mail* zyrtar, Ministrja znj. Besa Shahini, i ka komunikuar asaj vendimin mbi moskualifikimin. Komisioni i ri, i cili ka nënshkruar, është i ndryshëm nga ai që ka vendosur. Sipas ankueses, komisioni i ri, nuk kishte pse të merrte në shqyrtim dosje, për të cilën ishte shqyrtuar njëherë nga komisioni i mëparshëm në datë 06.08.2019 dhe kishte një vendimarrje për këtë aplikim. Sipas saj, komisioni i ri i ngritur, nuk ka shqyrtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e ankueses, por ai është mbështetur në një vendimarrje të mëparshme të Komisionit të Përzgjedhjes për rastin e aplikantit F.J.

Sipas ankueses rasti i mësipërm i aplikantit F.J, i cili është trajtuar sipas procesverbalit nr.6, datë 03.11.2016, rezultoi se ka përfunduar studimet Bachelor. Pra, diploma e këtij aplikanti nuk ka qenë e njëjtë me diplomën e ankueses, e cila është Diplomë Bachelor With Second Class Honours. Në këtë mënyrë sipas ankueses as arsimit bazë (bachelor) dhe as mesatarja nuk ka qenë e njëjtë.

Sipas ankueses, rasti i aplikantit J.H, i trajtuar sipas procesverbalit nr.5, datë 28.08.2018, i paraqitur si provë nga Ministria gjatë procesit gjyqësor si precedent, për të cilin Komisioni i Përzgjedhjes ka marrë të njëjtin vendim duke e skualifikuar sepse nuk ka plotësuar mesataren,

nuk mbështet vendimarrjen e ministrisë. Ankuesja shpjegon se rasti i J.H është trajtuar sërish nga Sekretariati Teknik dhe nga Komisioni i Përzgjedhjes, sepse vetë universiteti e klasifikon si student ekselence.

Sipas ankueses, Udhëzimi nr. 30, datë 29.12.2017, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së deftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë”, është i zbatueshëm në rastin e saj. Ajo shpjegon se në këtë udhëzim, vetëm për rastin e Mbretërisë së Bashkuar, tabela ka një pjesë extra të shënuar si (%) dhe aty ka sistemin e lartë Britanik, i cili nuk matet nga A deri në F, por me përqindje, si në tabelë, nga 34% si notë 4 Shqiptare dhe notën 10 Shqiptare me 64%. Sipas ankueses, nëse nota 10 shqiptare është e barabartë me 64% Britanike, atëherë nota e saj 62.5 % është e barabartë me 9.76 shqiptare. Ankuesja deklaron se vetë sistemi Britanik për fontet e veta të ekselencës që jep nëpërmjet ambasadave të tyre në mbarë botën, parashikon se duhet të kesh një 2.1 Honours Degree, në konvertimin sipas sistemit Britanik, që të mund të përfitosh. Sistemi Britanik di më mirë se çdo kush se cilën diplomë britanike klasifikon si ekselente dhe cilën jo. Sipas ankueses është e gabuar që nota 10 shqiptare është absolute 70%, sikundër është shprehur ministrja, znj. Besa Shahini. Sipas ankueses, nota 10 shqiptare duhet të bazohet mbi tabelën udhëzuese të ministrisë ose sipas universitetit përkatës dhe jo me hamëndje.

Ashtu si në Shqipëri, ku jo vetëm nota 10 klasifikohet si ekselente, por edhe 9.5 apo 9.6, edhe në Britani, jo vetëm kategoria e klasës së parë konsiderohet ekselente, por si e tillë konsiderohet edhe kategoria e quajtur “*Second Class Upper With Honours*” Ankuesja nuk pretendon se ka mbaruar studimet me notën 10 shqiptare, por pretendimi i MASR se ajo nuk është fituese e fondit të ekselencës se nuk ka 70 % është i pabazuar, pasi VKM-ja nuk mbështet vetëm studentët me notën 10.

Ankuesja shprehet se Komisioni nuk ka bërë konvertimin e mestares, në zbatim të VKM-së nr.483 datë 16.07.2014 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore”, por është shprehur se ajo nuk plotëson kriteret dhe i referohet rasteve të mëparshme. Sipas ankueses, pretendimi i përdorur në e-mail, në lidhje me skualifikimin, se nota e studimeve Bachelor është 62.5 %, është në kundërshtim me legjislacionin shqiptar, mesatarja e të cilit nuk kërkohet me përqindje, por e konvertuar në notë, e cila për ankuesen duhet të jetë mbi 9.5. Sipas ankueses, VKM-ja nr.483/16.04.2014, është diskriminuese edhe për faktin se, për shkencat natyrore vendos mesatare mbi 9, ndërsa për shkencat ekonomike dhe shoqërore mbi 9.5, pasi ekselentët nuk mund të kategorizohen në dy grupe për shkak të diplomës.

Ankuesja deklaron se, që prej qershorit 2019, kur ka kontaktuar me MASR për konvertimin e notës së saj Britanike dhe deri tani, ende nuk i është bërë konvertimi i notës Britanike në notën Shqiptare. Në këtë mënyrë, ankuesja shprehet se, është privuar edhe nga e drejta për të aplikuar për punë, të cilat kanë kritere një notë të caktuar mesatare. Si pasojë e stresit dhe

zvarritjeve, ankuesja deklaron se ka pësuar atak paniku dhe ka përfunduar në spital dhe është detyruar të marrë një kredi për të paguar pjesën e parë për në Oxford University.

Përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen marrjen e masave si më poshtë:

- Rishikimin e VKM-së nr.483 datë 16.07.2014 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore”, e cila grupon me notë ndryshe ekselentët e shkencave ekzakte nga shkencat shoqërore (nota 9 për shkencat ekzakte dhe nota 9.5 për shkencat e tjera)
- Rishikimin e Udhëzimit nr.30, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së deftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë”, të MASR, pasi të njëjtat nota përbëjnë edhe sistemin e lartë të cilin qëllimisht nuk e vendosin me tabelë konvertimi.
- Rishikimin e aplikimit të ankueses për Fondin e Ekselencës.
- Detyrimin për konvertimin e notës Britanike në atë Shqiptare.
- Detyrimin për pagesën e masterit sipas Universitetit të Oxfordit.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprim ose mosveprim, të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.592/2 prot., datë 15.04.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga MASR dhe Këshilli i Ministrave (në vijim KM).
2. Me shkresën nr.1969/1 prot., datë 20.04.2021, KM ka kthyer përgjigje, duke informuar Komisionerin se, ndjekja e ankesës do të bëhej nga ana e MASR. Me shkresën nr. 2230/2 prot., datë 26.04.2021, MASR ka kthyer përgjigje, duke parashtruar sa vijon:

2.1 Vendimarrja e Komisionit Përzgjedhës mbi aplikimin e R.S në programin e Fondit të Ekselencës është marrë në mbledhjen e zhvilluar më datën 30.08.2019 dhe është zbardhur në procesverbalin nr. 7, datë 02.09.2019 *“Për marrjen në shqyrtim të dokumentacionit të kandidatëve që kanë aplikuar për ndjekjen e studimeve Bachelor, Master dhe Doktoratë për vitin akademik 2019-2020”*. MASR, në përgjigjen e saj shprehet se, për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Mbretërinë e Bashkuar, vetëm të diplomuarit me notën First Class (70-100) janë konsideruar ekselentë. Asnjë kandidat me diplomë të ciklit të parë, me vlerësimin Second Class (si në rastin e R.S) të fituar në Mbretërinë e Bashkuar, nuk është financuar nga Programi i Fondit të Ekselencës për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë jashtë vendit. MASR shprehet se, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të VKM-së nr.483, datë 16.07.2014, është aplikuar i njëjti standart për të gjithë kandidatët dhe për rrjedhojë pretendimi për diskriminim nuk qëndron.

2.2 Në lidhje me pretendimet e ankueses, mbi rishikimin e aplikimit të saj për Fondin e Ekselencës, detyrimin për pagesën e masterit, etj, MASR, shprehet se, ankuesja i është drejtuar gjykatës administrative, kundër vendimit të Komisionit Përzgjedhës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka shqyrtuar padinë e R.S dhe me vendimin nr. 4265, datë 10.12.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Përzgjedhës. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.170, datë 16.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

2.3 Në lidhje me pretendimet e ankeses mbi ndryshimet në përbërjen e Komisionit Përzgjedhës, MASR, shprehet se ka mjaft pasaktësi dhe të pavërteta në parashtrimin e fakteve. Ministria, sqaron se, pretendimi i ngritur nga ankuesja se, MASR, më datën 29.08.2019, ka ndryshuar përbërjen e Komisionit Përzgjedhës, duke vendosur si Kryetar të Komisionit, Sekretarin e Përgjithshëm të MASR, është i pavërtetë. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, ministri përgjegjës për arsimin kryeson Komisionin Përzgjedhës të Fondit të Ekselencës. Përmes urdhrin nr.241, datë 25.04.2019, ministri e kishte deleguar këtë kompetencë të tij tek zëvendësministri që mbulon çështjet e arsimit të lartë. Ky urdhër u shfuqizua me anë të urdhrin nr.430, datë 29.08.2019 dhe ministri ushtroi kompetencën e tij si Kryetar i Komisionit Përzgjedhës të Fondit të Ekselencës. Sekretari i Përgjithshëm i MASR, në asnjë moment gjatë vitit 2019, nuk ka qenë Kryetar i Komisionit Përzgjedhës. Gjatë kësaj periudhe, nuk është krijuar ndonjë komision i ri përzgjedhës, pasi asnjë anëtar i Komisionit Përzgjedhës nuk është ndryshuar apo zëvendësuar.

2.4 Për periudhën 2014-2019, procedurat dhe kriteret për të përfitur nga Programi i Fondit të Ekselencës kanë qenë të përcaktuara në vendimin nr.483, datë 16.07.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)”* dhe dhëzimit nr.16, datë 01.08.2014 të Ministrin të Arsimit dhe Sportit *“Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për fituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”*, i ndryshuar.

Aktualisht, procedurat dhe kriteret për të përfitur nga Programi i Fondit të Ekselencës janë përcaktuar në vendimin nr.160, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)” dhe udhëzimin nr.6, datë 04.02.2020 të MASR “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”.

2.5 Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga MASR, rezulton se, për vitin akademik 2019-2020, në programin e Fondit të Ekselencës kanë aplikuar 36 kandidatë, nga të cilët janë shpallur 8 kandidatë fitues për ndjekjen e studimeve të ciklit të parë jashtë vendit dhe 13 kandidatë fitues për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë jashtë vendit. Lidhur me kandidatët që janë financuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të parë jashtë vendit, 5 prej tyre e kishin përfunduar arsimin e mesëm të lartë brenda vendit dhe 3 të tjerë, jashtë vendit, ndërkohë që për kandidatët e financuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë jashtë vendit, 7 prej tyre i kishin përfunduar studimet e ciklit të parë brenda vendit dhe 6 jashtë vendit.

2.6 MASR, shpjegon se, procedurat për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave të fituara jashtë vendit, të cilat i përkasin nivelit 5-8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve janë përcaktuar në udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, të ndryshuar. Në këtë udhëzim nuk përcaktohen procedura për konvertimin e mesatareve të huaja të arsimit të lartë në sistemin shqiptar të vlerësimit. MASR, shpjegon se, aktualisht nuk ka një akt ligjor apo nënligjor që parashikon mënyrën e ekuivalentimit të notave të sistemit të lartë të institucioneve të huaja me sistemin shqiptar, pasi vende të ndryshme kanë sisteme të ndryshme vlerësimi. Sipas ministrisë, Komisioni Përzgjedhës ndër vite është bazuar në klasifikimin që universitetet e huaja i bëjnë sistemit të tyre të vlerësimit. Komisioni Përzgjedhës kualifikon ata studentë, të cilët në vendin ku kanë kryer studimet klasifikohen si studentë të shkëlqyer.

2.7 Në lidhje me kriterin e mesatares së studimeve pararendëse të përcaktuar në pikën 2/a/ii, të vendimit nr.483, datë 16.07.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe specifikisht në raport me përcaktimin e mesatares minimale 9 për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në shkencë natyrore dhe teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike dhe shoqërore, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare, ministria sqaron se, në bazë të hulumtimeve për rezultatet brenda dhe jashtë vendit, është arritur në përfundimin se, arritja e rezultateve të larta në programet e studimit që i përkasin fushës së shkencave natyrore/teknike është përgjithsisht më e vështirë se arritja e rezultateve të larta në programet

e studimit që i përkasin fushës së shkencave natyrore. Për të amortizuar vështirësinë e shtuar në arritjen e rezultateve të larta nga kandidatët që ndjekin studimet në shkencat natyrore/teknike, është vendosur që për këta kandidatë të vendoset kriteri i mesatares pak më i ulët (9).

MASR, shprehet se në asnjë rast nuk ka patur diskriminim kundrejt R.S, në procedurën e vendimarrjes së Komisionit Përzgjedhës, lidhur me aplikimin e saj në programin e Fondit të Ekselencës.

II. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Ankuesja R.S, ka kryer studimet në ciklin e parë të studimeve në Universitetin Napier të Edinburgut, në Mbretërinë e Bashkuar, në programin 4-vjeçar, 240 ECTS në Gjuhë dhe Menaxhim Marketingu. Me vendimin nr. 939, datë 04.09.2012, Komisioni i Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka njohur diplomën e ankueses duke e njehsuar atë si Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë.

Ankuesja ka aplikuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në Oxford University dhe Kembrixh University, në Mbretërinë e Bashkuar. Të dy këto universitete kanë pranuar kërkesën e ankueses për ndjekjen e studimeve universitare. Në vijim të aplikimit në Kembrixh University, ankuesja ka paguar tarifën e rezervimit në shumën prej 10 000 pound si studente potenciale për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë pranë këtij universiteti.

Ankuesja ka paraqitur pranë MASR, aplikimin nr.7657 prot., datë 30.07.2019, për mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, në fazën e dytë të aplikimeve 1 gusht-30 shtator 2019.

Komisioni Përzgjedhës i Programit të Ekselencës, në lidhje me aplikimet e dorëzuara, për të përzgjedhur studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civil, fitues të mbështetjes financiare nga Fondi i Ekselencës për fazën e dytë të vitin akademik 2019-2020, ka pasqyruar përfundimet e tij për përzgjedhjen e fituesve të kualifikuar dhe aplikimet që nuk janë kualifikuar, në procesverbalin e mbledhjes me nr.7 prot., datë 02.09.2019. Komisioni Përzgjedhës, ka bërë vlerësimin si vijon:

- *R.S, aplikon për studimet e ciklit të dytë “Master”, viti I, në programin e studimit MBA me kohëzgjatje 2 (dy) vjeçare (21 muaj), në Oxford University, Mbretëri e Bashkuar. Znj. S ka përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” me mesatare 62.5/100 (second Class) në Universitetin Napier, Edinburg, Mbretëri e Bashkuar.*

- Në mbështetje të pikës 2/a/vii, të vendimit nr.483, datë 16.07.2014, të Këshillit të Ministrave, studentët që aplikojnë për financimin e studimeve “Master” duhet të kenë mbaruar studimet e ciklit të parë me mesatare minimalisht 9.5 për shkencat shoqërore dhe ekonomike.
- Në bazë të vendimarrjes së mëparshme të Komisionit Përzgjedhës, pasqyruar në procesverbalin nr.5, datë 28.08.2018, mbi një rast të ngjashëm të trajtuar në vitin e kaluar, është përcaktuar mesatarja 70-100 në sistemin anglez është ekuivalente me 9-10 në sistemin shqiptar të vlerësimit.
- Ndërkohë që një rast të vitit 2016, në procesverbalin nr.6, datë 03.11.2016, Komisioni Përzgjedhës shprehet: “.....vetëm diploma me klasifikimin “First Class, 70-100 pikë, Grade A, do të ekuivalentohet me notën “9.5” në sistemin e vlerësimit në Shqipëri”. Gjithashtu, znj.F.J (Master) e pajisur me diplomë të ciklit të parë me vlerësimin Second Class, Division I (si në rastin e znj.S) është skualifikuar në vitin 2016 për mos përmbushje të kriterit të mesatares të përcaktuar në VKM.
- Për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të I në Mbretërinë e Bashkuar, vetëm të diplomuarit me notën First Class (70-100) janë konsideruar ekselentë.
- Për sa më sipër, znj. R.S nuk kualifikohet pasi nuk plotëson kriterin e mesatares të përcaktuar në pikën 2/a/vii, të vendimit nr.483, datë 16.07.2014, të Këshillit të Ministrave.”

Rezulton se, kundër vendimarrjes së Komisionit Përzgjedhës, ankuesja ka paraqitur padi në gjykatë. Nga aktet e administruara rezulton se me vendimin nr. 4165, datë 10.12.2019, Gjykata Administrative e Shallës së Parë Tiranë, ka vendosur të rrëzojë kërkesë padinë e paraqitur nga ankuesja, duke e gjetur të drejtë vendimarrjen e Komisionit Përzgjedhës, i cili nuk e ka përzgjedhur ankuesen si kandidate fituese për të përfituar mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.170, datë 16.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ankuesja duke pretenduar se është diskriminuar nga vendimarrja e Komisionit Përzgjedhës, të Programit të Ekselencës, për shkak të gjuhës, shtetësisë, gjendjes arsimore dhe vendbanimit, ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën Nr.57 Regjistri, datë 06.04.2021, kundër MASR.

A.1 Legjislacioni i zbatueshëm.

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.10221/2010)

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike,

gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.
2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.
3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.
.....
4. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.

Neni 6

Trajtimi i ndryshëm i përligjur

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të

padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

Neni 17

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;

b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;

c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;

ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

Ligji Nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹ (në vijim ligji nr.9741/2007)

Neni 37

Njohja e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të huaj

1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njësohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e certifikatave, gradave ose titujve të huaj.

2. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të diplomave ose certifikatave, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila e kryen këtë proces nëpërmjet njësisë përgjegjëse të njohjes së diplomave, që funksionon edhe si Qendra Kombëtare e Njohjes së Diplomave dhe e Informimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të autorizojë institucionet e arsimit të lartë për kryerjen e këtij procesi për rastet e njësimit të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin. Këto raste përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave ose titujve shkencorë, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë.

4. Procedurat dhe kriteret për njohjen e diplomave, certifikatave, gradave e titujve, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, përcaktohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe

¹ Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Shkencës, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim

Neni 57

Bursa për studime

1. Studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë përfitojnë bursa si mbështetje ekonomike për studimet e tyre, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.
2. Bursat, sipas pikës 1, të këtij neni, përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacione të ndryshme. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret shtetërore dhe procedurat për përfitimin e bursave.
3. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statutet e tyre kriteret dhe procedura për shpërblime të studentëve, që përballohen nga vetë institucionet.
4. Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, këshilli i Ministrave konsideron dhe raste të tjera për dhënie bursash, si dhe bursa për studentë të shkëlqyer dhe shkencëtar.

Udhëzim nr.41, datë 8.12.2009, “Për procedurat e njohjes së diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, i ndryshuar. (në vijim udhëzimi nr.41/2009)

4.4 Në përfundim të procedurës, aplikantit i lëshohet një vërtetim njohjeje dhe njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës. Vërtetimi nënshkruhet nga kryetari i Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Formati i vërtetimit të njohjes dhe njehsimit, bashkëlidhur shtojca nr. 1, përmban këto elemente:

- a) emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit;
- b) institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;
- c) shtetin përkatës;
- d) kohëzgjatjen e programeve të studimit;
- e) titullin e diplomës;
- f) emërtimin e programit të studimeve të kryera shoqëruar me kreditet e përfituata sipas sistemit ECTS (European Credit Transfer System-Sistemi European i Transferimit të Krediteve), në ato raste kur është e mundur të përcaktohet në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës ose listës së notave.
- g) njehsimin e diplomës përkatëse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.483, datë 16.07.2014, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)” (në vijim VKM nr.483/2014)

1. Financimin nga buxheti i shtetit në masën jo më pak se 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milion lekë) në vit të Fondit të Ekselencës, si dhe financimin nga donacione apo të ardhura të tjera nga burime të ligjshme për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për bursa për studentët që ndjekin studimet e

ciklit të parë, të dytë apo studime të doktoraturës jashtë vendit në universitetet më të mira të botës si dhe për nëpunësit civilë të administratës shtetërore apo në varësi të saj, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi.

2. Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara më poshtë:

a) Studentët, që ndjekin jashtë vendit ciklin e parë dhe/ose ciklin e dytë të studimeve universitare, kur:

i. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike sipas fushave, nga “Times Higher Education” –Renditja botërore e universiteteve për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit, ose kanë përfituar financim/bursë në masën 75 për qind të shpenzimeve totale të parashikuara nga universiteti pritës (për tarifën e shkollimit dhe kosto të tjera të jetesës), në rastet kur universiteti është i akredituar dhe i mirënjohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në rastin e dytë mbështetja financiare nga Fondi i Ekselencës nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 euro në vit;

.....

vi. kanë përfunduar studimet parauniversitare me mesatare mbi 9 të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit, për studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve universitare;

vii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare.

4 Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, zbatimin e kriterëve, procedurave dhe përcaktimin e masës e të mënyrës së financimit për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

5 Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të vitit akademik nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të kryesuar prej tij.

Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 16, datë 01.08.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”, i ndryshuar. (në vijim udhëzim i MAS nr.16/2014)

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

2. Për vlerësimin fillestar, përzgjedhjen e kandidatëve dhe ecurinë e tyre gjatë studimeve, Ministri i Arsimit dhe Sportit formon dy komisione përzgjedhëse: një komision për

përzgjedhjen e studentëve të shkëlqyer të cilët do të ndjekin studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e doktoraturës dhe një komision për përzgjedhjen e nëpunësve civilë të administratës shtetërore që do të ndjekin një program 1 vjeçar, master të ciklit të dytë ose të tretë.

3

Për administrimin e dokumentacionit të Fondit të Ekselencës, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit formohet një Sekretariat Teknik i Programit (STP), i përbërë nga personel administrativ i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. STP mbështet teknikisht punën e Komisioneve Përzgjedhëse (KP)

STP është përgjegjës për të ndjekur plotësimin e dosjes nga kandidati dhe verifikimin e dokumenteve shkollorë të paraqitur nga kandidati si dhe ndjekjen e procedurave të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

4

b. Kandidatët që do të ndjekin vitin e dytë apo pas tij të studimeve të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në periudhat 1-31 ose 1 shtator -15 tetor të çdo viti.

6.1 Aplikimi fillestar duhet të përmbajë dokumentet e parashikuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.²

8. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit duke ndjekur hapat dhe fazat e mëposhtme:

.....

9.1 Faza e përzgjedhjes paraprake:

a. STP bën një vlerësim paraprak për plotësimin e kriterëve të parashikuar në vendimin nr.483, datë 16.07.2014 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)” dhe në këtë udhëzim, nga kandidatët. Vlerësimi paraprak së bashku me dosjet e kandidatëve i kalon për shqyrtim KP, i cili bën vlerësimin për çdo aplikant. Pas këtij vlerësimi, KP kryen klasifikimin për fazën e intervistës.

b. STP njofton përmes e-mailit kandidatët që janë përzgjedhur për t’u intervistuar për datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave.

9.2 Faza e përzgjedhjes përfundimtare:

² Dokumentacioni i kërkuar sipas shtojcës : Formular aplikimi; Diplomat universitare të ciklit të parë dhe/ose të dytë të studimeve universitare së bashku me aneksin e notave; letër pranimit nga institucioni pritës I arsimit të lartë.

- a. KP kryen intervistën me të gjithë kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga përzgjedhja paraprake. Intervista kryhet në prezencë të kandidatit ose në rrugë telematike kur ai ndodhet jashtë vendit.
- b. Kandidati, 3 ditë pas intervistës me KP, plotëson aplikimin me dokumentacionin e kërkuar në shtojcën 4, të këtij udhëzimi.³
- c. KP mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, të intervistës si dhe të dokumentacionit të aplikimit me dokumentacionin e kërkuar në pikën b, bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve
- d. Vendimet (procesverbalet e mbledhjes) e KP i bashkëlidhen urdhrin të ministres për shpalljen e kandidatëve fitues ku është parashikuar edhe masa e bursës së akorduar secilit prej tyre”.

Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.80/2015)

Neni 4

E drejta për arsimim

1. Të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë e kanë të gjithë ata individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi dhe nga institucionet e arsimit të lartë.
2. Shteti garanton arsimimin edhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato.
3. Arsimi u garantohehet në këto programe studimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.
4. Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 6

Përkufizime

³ Dokumentacioni i kërkuar sipas shtojcës : Formular aplikimi; Kopje të pasaportës/kartës së identitetit; vërtetim të qendrës së banimit; CV e hollësishme, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV; Dokument që vërteton përfundimin me sukses të studimeve të shkollës së mesme (deftesë pjekurie, certifikatë e maturës shtetërore, etj) dhe/ose diplomës e përfundimit të ciklit të parë të studimeve universitare; Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë; Planin e studimit për programin që do të ndjekë kandidati në universitetin pritës; Një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit; në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASR dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose të huaja të paraqitet kopje e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përfunduar ato shtetërore); Tri rekomandime origjinale për cilësitë e kandidatit.

3. “Bursa” është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kritereve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 92

Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë

1. Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.
2. Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.
3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësi përgjegjëse e njësimit të diplomave.
4. Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.
5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin.
6. Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar, sipas fushës së punësimit.
7. Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë.

Neni 112

Granti i mësimdhënies

4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.

Neni 142

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet e nënligjore të parashikuara në nenin 139 të këtij ligji

Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar. (në vijim udhëzimi i MAS nr.17/2016)

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

Të drejtën për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituara jashtë vendit, e ka Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Njohja dhe njësimi ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e njohjes dhe njësimit të diplomave dhe certifikatave, nënkupton administrimin dhe kryerjen e procedurave për të gjitha aplikimet për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, apo nga institucione të tjera të autorizuara nga kuadri ligjor i vendit përkatës për lëshimin e tyre.

Kreu IV

Procedurat e njohjes (pika 6)

Vërtetimi i njohjes dhe njësimit (me përjashtim të gradave shkencore dhe titujve akademikë):

- a. Lëshohet nga QSHA (nënshkruhet nga titullari i QSHA dhe Kryetari i Komisionit të Njohjes) në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet procesverbalit përkatës dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).
- b. Përmban minimalisht elementët e mëposhtëm:
 - i. Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
 - ii. Institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;
 - iii. Shtetin përkatës;
 - iv. Numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);
 - v. Emërtimin e plotë të programit të studimit;
 - vi. Kohëzgjatja e programit të studimit;
 - vii. Data e përfundimit të studimeve;
 - viii. Njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë;
- c. Formulimi grafik i vërtetimit të njohjes dhe njësimit përcaktohet nga struktura përkatëse e QSHA”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.160, datë 19.02.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)” (në vijim VKM nr.160/2020)

1. Financimin nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës për Fondin e Ekselencës, dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme, për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga ministria përgjegjëse për arsimin për bursa për:
 - a. Studentët, të cilët ndjekin studimet e ciklit të dytë apo të tretë jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës;
 - b. Nëpunësit civilë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:
 - a. Studentët, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë kur:

.....

 - ii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore;
 - iii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës, sipas renditjes së përgjithshme [ër vitin përkatës të aplikimit dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, nga “Times Higher Education” – Rënditja botërore e universiteteve, për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë;
5. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve e procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni, për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili miratohet brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
6. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të vitit akademik, nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Komisioni

përzgjedhës kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose personi i deleguar prej tij, në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues.

Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.6, datë 04.03.2020 “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë” (në vijim udhëzim i MASR nr.6/2020)

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

3. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve përpara fillimit të vitit akademik dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë studimeve, ngrihet komisioni përzgjedhës nga ana e Ministrisë përgjegjës për arsimin, sipas përbërjes dhe kriterëve përzgjedhëse të parashikuara në këtë udhëzim.

.....

4. Për administrimin e dokumentacionit të aplikimeve në programin e Fondit të Ekselencës dhe për ndjekjen dhe gjurmimin e ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore/nënligjore dhe atyre të parashikuara në aktmarrëveshje, Ministri përgjegjës për arsimin formon Sekretariatit Teknik të Programit (STP), të përbërë nga personel administrativ i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Përbërja dhe detyrat e STP përcaktohen me urdhër ministri, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

Kreu II

Procedurat e aplikimit

1. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare nga Fondi i Ekselencës kryhet në formën elektronike në portalin e-albania ose në sistemin online përkatës të shërbimeve.
2. Periudha gjatë së cilës kryhen aplikimet për secilin vit, për të gjitha kategoritë e përfituesve të përcaktuara në vendimin nr.160, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar, shpallet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Kreu III

Procedurat e përzgjedhjes

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Ministria përgjegjëse për arsimin sipas procedurës si më poshtë:

.....

1.1 Fazat e përzgjedhjes :

- a. STP bën një vlerësim paraprak për plotësimin e kriterëve të parashikuar në vendimin nr.160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe në këtë udhëzim, nga të gjithë kandidatët, duke përfshirë kandidatët që kanë përfituar mbështetje nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për vitin e dytë e në vijim të studimeve.
- b. Vlerësimi paraprak së bashku me dosjet e kandidatëve i kalon për shqyrtim Komisionit i cili bën vlerësimin për çdo kandidat.
- c. Pas këtij vlerësimi, Komisioni merr vendim për kandidatët që përfitojnë mbështetje nga fondi i ekselencës. Ky vendim zbardhet në procesverbalin përkatës në të cilin përcaktohet lista e kandidatëve fitues, si dhe shumat e financimit për secilin prej tyre të cilat janë të përlllogaritura paraprakisht nga STP, pasi është marrë informacioni nga drejtoria përgjegjëse për Buxhetin dhe menaxhimin Financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin mbi masën e fondit në dispozicion.

.....

1.2 Shpallja e kandidatëve fitues

- a. Lista e emrave me kandidatët fitues duke përfshirë të dhënat mbi programin e studimit, institucionin e arsimit të lartë, renditjen sipas “*Times Higher Education*”- Rënditja botërore e universiteteve, si dhe masën e financimit, bëhet publike në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- b. Kandidatët njoftohen, përmes emailit, për klasifikimin e tyre si fitues ose jo fitues.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

A.2 Analiza ligjore në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese.

Në rastin konkret, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në kuadër të aplikimit që ajo kishte bërë pranë MASR, për të përfituar mbështetje financiare, në kuadër të Fondit të Ekselencës, me qëllim ndjekjen e ciklit të dytë të studimeve, “Master”, jashtë vendit dhe konkretisht në Mbretërinë e Bashkuar.

Në kohën e aplikimit të ankueses, kuadri ligjor i zbatueshëm dhe që ka rregulluar procedurat për të përfituar nga Fondi i Ekselencës, kanë qenë të zbatueshme parashikimet e ligjit nr. 80/2015, VKM nr.483/2014 dhe udhëzimi i MASR nr.16/2014, i ndryshuar.VKM nr.483/2014 dhe udhëzimi i MASR nr.16/2014, janë akte nënligjore të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.9741/2007 (*ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr.80/2015*). Aktualisht, këto dy akte nënligjore, VKM-ja dhe udhëzimi i MASR, janë zëvendësuar me dy akte të reja të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 80/2015, dhe konkretisht VKM nr.160, datë 19.02.2020 dhe udhëzimi i MASR nr.6, datë 04.03.2020.

Neni 57, i ligjit nr.9741/2007, i cili ka autorizuar miratimin e VKM nr.483/2014, për Fondin e Ekselencës, ka parashikuar se , në bazë të propozimit të ministrit që mbulon çështjet e arsimit, Këshilli i Ministrave konsideron dhënien e bursave për studentët e shkëlqyer. Ndërsa, referenca që është bërë në VKM nr. 160/2020, (*akt i cili ka zëvendësuar VKM nr.483/2014*), është neni 112, i ligjit 80/2015. Pra, është pikërisht kjo dispozitë ligjore e cila ka autorizuar miratimin nga ana e Këshillit të Ministrave të VKM nr.160/2020.

Sipas nenit 112, të ligjit nr.80/2015, të qënit student ekselent është i lidhur me pasjen e një note mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, që studentët kanë zgjedhur të ndjekin studimet. VKM nr.483/2014, mbi bazën e të cilës janë rregulluar procedurat e Fondit të Ekselencës, për rastin e ankueses, edhe pse është një akt i miratuar bazuar në ligjin nr.9741/2007, i cili ka qenë i shfuqizuar në ato momente, ka qenë i zbatueshëm bazuar në dispozitën transitorë të ligjit nr. 80/2015, konkretisht nenin 142, për sa kohë nuk bie të kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Ligji nr. nr.9741/2007 nuk ka bërë dallime në lidhje me të drejtën e përfitimit të bursave midis studentëve të shkëlqyer që kanë përfunduar studimet brenda vendit dhe atyre që kanë përfunduar studimet jashtë vendit. Në mënyrë të ngjashme edhe ligji nr.80/2015, nuk bën dallime midis këtyre dy kategorive të studentëve.

Bazuar në VKM nr.483/2014, mbështetja financiare e shtetit për ndjekjen e studimeve jashtë vendit, ofrohet për këto kategori :

- studentët shqiptarë të shkëlqyer që ndjekin studimet e ciklit të parë jashtë vendit në një nga institucionet më të mira të botës;
- studentët shqiptarë të shkëlqyer që ndjekin studimet e ciklit të dytë jashtë vendit në një nga institucionet më të mira të botës;
- studentët shqiptarë të shkëlqyer që ndjekin studimet e doktoraturës jashtë vendit në një nga institucionet më të mira të botës;
- si dhe për nëpunësit civilë të administratës shtetërore apo në varësi të saj.

VKM nr.483/2014, ka parashikuar se, për të përfituar nga Fondi i Ekselencës për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë, pra “Master, sikundër është rasti i ankueses, ndër disa kriteret që aplikantët duhet të përmbushin, kërkohet edhe fakti që, aplikantët duhet të kenë përfunduar

studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare. Në rastin e ankueses, e cila ka aplikuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në shkencat ekonomike e shoqërore, rezulton se, ankuesja duhet të përmbushë kriterin e notës mesatare 9.5, me qëllim që të përfitojë nga Fondi i Ekselencës. Sipas vendimarrjes së Komisionit Përzgjedhës, të krijuar nga MASR, në kuadër të procedurave të Fondit të Ekselencës, ankuesja nuk është kualifikuar për të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të notës mesatare 9.5.

Referuar VKM nr.483/2014, nota mesatare është vendosur si kriter edhe për aplikantët që duan të ndjekin studimet e ciklit të parë të studimeve. Për këtë kategori, në pikën 2/a/vi, të VKM, përcaktohet se ata duhet të kenë përfunduar studimet parauniversitare me mesatare mbi 9, të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit.

Sipas VKM nr.483/2014, nota mesatare nuk është kusht për aplikantët që duan të ndjekin studimet e doktoraturës ose nëpunësit civil të administratës shtetërore apo në varësi të saj.

Bazuar në ligjin nr.80/5015 dhe VKM nr.483/2014, që përbën kuadrin normues të Fondit të Ekselencës, kriteret e vendosura për të përfituar nga kjo mbështeje për ndjekjen e studimeve, kriteri i notës mesatare, duhet të zbatohet në mënyrë të njëjtë për të dy kategoritë e studentëve, ata që kanë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë brenda vendit dhe ata që kanë përfunduar këto studime brenda vendit. Pra, kuadri ligjor dhe nënligjor nuk bën diferencime.

Për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në ciklin e parë të studimeve brenda vendit dhe kanë aplikuar për të përfituar nga Fondi i Ekselencës për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë jashtë vendit, procedurat në lidhje me përcaktimin e notës mesatare, janë të mirëpërcaktuara sipas kuadrit të brendshëm ligjor e nënligjor. Konkretisht organizimi i studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, bëhen konform parashikimeve të udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr.15, datë 04.04.2008 “*Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë*”. Ky udhëzim është miratuar në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.9741/2007, i cili është shfuqizuar dhe vazhdon të jetë në fuqi pasi nuk janë miratuar aktet e reja nënligjore në zbatim të ligjit nr.80/2015, në lidhje me këtë aspekt të ndjekjes së studimeve në arsimin e lartë.

Në lidhje me studentët të cilët kanë përfunduar studimet në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit, përfshirë ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, sikundër ankuesja, rezulton se, nuk ka akte ligjore ose nënligjore që të normojnë dhe rregullojnë procedurat në lidhje me konvertimin e notave që këta studentë kanë përfituar nga ndjekja e studimeve të larta jashtë vendit. Një fakt i tillë pranohet edhe nga vetë MASR në përgjigjen e saj të dërguar në lidhje me ankesën.

Ankuesja ka kryer ciklin e parë të studimeve, në Universitetin Naiper të Edinburgut, në Mbretërinë e Bashkuar, në programin 4-vjeçar, 240 ECTS në Gjuhë dhe Menaxhim

Marketingu. Me vendimin nr.939, datë 04.09.2012, Komisioni i Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka njohur diplomën e ankueses duke e njehsuar atë si Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë, por njohja dhe njësimi i diplomës së ankueses nuk është shoqëruar edhe me konvertim të notave që ajo ka fituar në universitetin jashtë vendit, me nota sipas sistemit të vlerësimit në Shqipëri.

Njohja dhe njësimi i diplomës së ankueses, të fituar në përfundim të studimeve të ciklit të parë, jashtë vendit, si më lart, është bërë bazuar në ligjin nr. 9741/2014 dhe udhëzimit nr.41/2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (*me ndryshimet përkatëse*). Komisioneri konstaton se, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, procesi i njohjes dhe njësimit të diplomave universitare të fituara jashtë shtetit, nuk është shoqëruar me konvertimin e notave, sikurse edhe ka ndodhur në rastin e ankueses. Rezulton se, edhe me miratimin e akteve të reja në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.80/2015, procesi i njohjes dhe njësimit të diplomave të fituara jashtë vendit, nuk shoqërohet me procedura për konvertimin e notave.

Bazuar në nenin 112, të ligjit nr.80/2015, diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

Në situatën në të cilën gjendet ankuesja, për të përfitur nga mundësia që ofrohet, për të siguruar mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, për të vazhduar arsimin dhe për të ndjekur studimet e larta në ciklin e dytë, jashtë vendit, ankueses i kërkohet edhe që të vërtetojë se ajo plotëson kriterin e mesatares 9.5, që i korrespondon llojit të diplomës në fushën e shkencave ekonomike dhe shoqërore. Nëse për studentët që duan të përfitojnë nga e drejta që ofrohet nga Fondi i Ekselencës, rezultojnë të përcaktuara procedurat në lidhje me përcaktimin e notës mesatare, në rastin e studentëve që zotërojnë një diplomë të fituar jashtë vendit, sikundër është edhe ankuesja, nuk ka procedura të përcaktuara. Pra, kategoria e studentëve që kanë fituar një diplomë universitare të fituar jashtë shtetit, përballen me pasigurinë dhe duhet të kalojnë gjithmonë në varësi të rastit në procedura për konvertimin e notave të tyre të fituara si rezultat i studimeve universitare të kryera jashtë vendit.

Në rastin e ankueses, rezulton se, për të vlerësuar në lidhje me përmbushjen e kriterit të mesatares, Komisioni Përzgjedhës i Fondit të Ekselencës, ka vlerësuar se ankuesja nuk e përmbush kriterin e notës mesatare 9.5 të përcaktuar nga pika 2/a/ii të VKM nr.483/2014, pasi diploma e e saj “*Bachelor*” me mesatare 62.5/100 (Second Class), e fituar jashtë vendit, në Universitetin Naiper, Edinburg, Mbretëri e Bashkuar, nuk ekuivalentohej me notën 9.5 në sistemin e vlerësimit në Shqipëri. Në përgjigjen e dërguar nga MASR, ajo shprehet se, për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Mbretërinë e Bashkuar, vetëm të diplomuarit me notën “*First Class*” (70-100) janë konsideruar ekselentë. MASR thekson se, asnjë kandidat me diplomë të ciklit të parë me vlerësimin “*Second Class*”, si në rastin e ankueses, të fituar në Mbretërinë e Bashkuar, nuk është financuar nga programi i Fondit të

Ekselencës, për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë jashtë vendit. Për rrjedhojë MASR, pretendon se gjatë gjithë periudhës së zbatimit të VKM nr.483/2014, është aplikuar i njëjti standart për të gjithë kandidatët dhe për rrjedhojë pretendimi për diskriminim nuk qëndron.

Në rastin konkret, rezulton se, në mungesë të një procedure dhe kriterëve të përcaktuara për konvertimin e notave të fituara jashtë shtetit nga ana e studentëve që kanë ndjekur studimet universitare, në institucione të huaja të arsimit të lartë, është kryer nga Komisioni Përzgjedhës. Ky Komision, ka ushtruar diskrecionin e tij, për të vlerësuar nëse ankuesja përmbushte ose jo kriterin e notës mesatare të kërkuar nga VKM nr.483/2014, duke u bazuar në praktikën dhe standartin e vendosur nga ky komision ndër vite gjatë zbatimit të Programit të Fondit të Fondit të Ekselencës. Referuar procesverbalit nr.6, datë 03.11.2016, të Komisionit Përzgjedhës, të mbajtur në kuadër të procedurave për të fituar nga Fondi i Ekselencës, sipas VKM nr.483/2014, për vitin akademik 2016-2017, Komisioni Përzgjedhës ka konkluduar se: *“Në mungesë të një akti zyrtar nënligjor, për ekuivalentimin e notave të sistemeve të vendeve të tjera, për të mundësuar vlerësimin e kriterit të notës mesatare, si një nga kriteret e përcaktuara në germën “vii”, të pikës 2, “a”, të vendimit nr. 483, datë 16.07.2014, Komisioni Përzgjedhës rikonfirmoi se në përfundim të ciklit të parë të studimeve bachelor, vetëm diploma me klasifikimin “First Class, 70-100 pikë, Grade A, do të ekuivalentohet me notën 9.5 në sistemin e vlerësimit në Shqipëri.”*

Në përgjigjen e dërguar pranë Komisionerit, MASR, ka shpjeguar se, arsyeja përse aktualisht nuk ka një një akt ligjor ose nënligjor, që parashikon ekuivalentimin e notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja me sistemin shqiptar, është se, vende të ndryshme kanë sisteme të ndryshme vlerësimi. Komisioni përzgjedhës ndër vite është bazuar në klasifikimin që universitetet e huaja i bëjnë sistemit të tyre të vlerësimit. Sipas Ministrisë, Komisioni përzgjedh dhe kualifikon ata studentë, të cilët, në vendin ku kanë kryer studimet, kualifikohen si studentë të shkëlqyer.

Komisioneri konstaton se, fakti që vende të ndryshme kanë sisteme të ndryshme vlerësimi, nuk e ka qenë pengesë për të rregulluar dhe për të përcaktuar kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet konvertimi i notave të fituara nga nxënësit të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit. Udhëzimi i MASR nr.44, datë 21.08.2013 *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së deftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”*, i ndryshuar, ka përcaktuar kriteret mbi bazën e të cilave bëhet konvertimi i notave, procedurën dhe autoritetin përgjegjës, që është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Por, ky udhëzim, i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.62/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ndryshe nga sa pretendohet nga ankuesja, nuk mund të gjejë zbatim në rastin e saj. QSHA, bazuar në udhëzimin nr.17, datë 03.08.2015, bën njehsimin dhe njohjen e diplomave universitare të fituara jashtë vendit, por nuk ka kompetencë për të kryer konvertim të notave që studentët kanë fituar në një nga institucionet e arsimit të lartë, jashtë vendit.

Në bazë të nenit 92, të ligjit nr.80/2015, njohja e diplomave, certifikatave e gradave, ose titujve, të përfituara jashtë vendit, duhet t'u mungësojë personave mundësinë për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri. Bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, mundësia për të vazhduar arsimin, punësimin ose karrierën akademike, për personat që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të garantohet në baza të barabarta me ata që kanë përfunduar studimet brenda vendit, pra pa diferencime që bazohen në faktin nëse personi e ka fituar diplomën, certifikatën, gradën apo titullin, nga një institucion i huaj i arsimit të lartë apo nga një institucion i arsimit të lartë vendas.

Diploma që ankuesja ka fituar në përfundim të studimeve të ciklit të parë të studimeve në Universitetin Naiper të Edinburgut, në Mbretërinë e Bashkuar, në programin 4-vjeçar, 240 ECTS në Gjuhë dhe Menaxhim Marketingu, i është njohur dhe njësuar ankueses bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor, si Master i Shkencave, në Republikën e Shqipërisë. Kjo procedurë, i ka mundësuar ankueses, që të plotësojë pjesërisht kriteret e vendosura në VKM nr.483/2014, vetëm në lidhje me faktin se ajo konsiderohet për efekt të kësaj VKM se ka përfunduar studimet e ciklit të parë "Bachelor".

Njehsimi dhe njohja e diplomës që ankuesja ka përfituar jashtë vendit, i ka mundësuar asaj plotësimin e kriterit në kuadër të Fondit të Ekselencës, duke u vlerësuar se ajo zotëron një diplomë Bachelor, që vërteton se ajo ka përfunduar studimet e ciklit të parë, por ky proces nuk i ka mundësuar në baza të barabarta, për shkak të mungesës së kriterëve dhe procedurave mbi bazën e të cilave do të duhet të konvertoheshin notat që ajo ka fituar në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga MASR, Komisioni Përzgjedhës, në mungesë të një kuadri ligjor dhe nënligjor për konvertimin e notave të fituara nga studentët në një institucion të juaj të arsimit të lartë, kualifikon ata studentë të cilët në vendin ku kanë kryer studimet klasifikohen si studentë të shkëlqyer. Referuar shpjegimeve të MASR, procesverbalit nr. 6, datë 03.11.2016, të Komisionit Përzgjedhës, ku ky komision është shprehur se: "...në përfundim të ciklit të parë të studimeve bachelor, vetëm diploma me klasifikimin "First Class, 70-100 pikë, Grade A, do të ekuivalentohet me notën 9.5 në sistemin e vlerësimit në Shqipëri." Komisioneri vlerëson se, është Komisioni Përzgjedhës që në fakt kryen ekuivalentimin e notës mestares.

Nga njëra anë qëndrimi i Ministrisë është se, konsiderohen ekselentë ata studentë që vlerësohen si të tillë nga universiteti që ka lëshuar diplomën/titullin/gradën, dhe nga ana tjetër është Komisioni Përzgjedhës që ekuivalenton rezultatin/diplomën në sistemin Shqiptar. Ndërkohë, neni 192, i ligjit nr.80/2015, thekson se, bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen atyre studentëve me notë mesatare në hyrje në rang vendi, pavarësisht nga programi i studimit dhe institucioni në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Pra, bazuar në këtë dispozitë, mesatarja e notave për t'u konsideruar si studentë i shkëlqyer, nuk varet nga vlerësimi i institucionit që ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet.

VKM nr.483/2014 ka vendosur se nota mesatare në hyrje, në rang vendi, për të përfitur bursën dhe për rrjedhojë mbështetjen financiare për të vazhduar arsimimin në një nga ciklet e studimeve të larta, jashtë vendit është, mbi 9 për shkencat natyrore dhe teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve. Këto nota mesatare të diferencuara sipas fushës përkatëse ku janë përfunduar ciklet e studimit, në llogjikën e ministrisë se, për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë ose të dytë jashtë vendit, përcaktohet nga vetë universitetet që kanë lëshuar diplomën, nuk gjen zbatim. Në llogjikën e Ministrisë, kjo mbetet e zbatueshme vetëm për studentët që kanë mbaruar ciklin e parë ose të dytë të studimit brenda vendit, pasi për ata që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, të qenit ekselentë do të bëhet nga universiteti që ka lëshuar diplomën, logjikë kjo që për sa është arsyetuar më sipër, është e pabazuar, pasi të qenit ekselentë sipas nenit 182, të ligjit nr.80/2015, përcaktohet bazuar në notën mesatare në rang vendi dhe jo nga institucioni ku studentit ka aplikuar për të ndjekur studimet.

Referuar dispozitave ligjore dhënia e mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer bëhet, bazuar në standartet dhe kriteret e përcaktuara në rang vendi dhe jo mbi bazën e kriterëve ose standarteve të përcaktuara nga vendi ose institucioni që ka lëshuar diplomën, në rastin konkret institucioni i arsimit të lartë i një vendi të huaj.

VKM nr.483/2014, për aplikantët që duan të përfitojnë mbështetje financiare për ndjekjen e ciklit të parë të studimeve, jashtë vendit, ka përcaktuar se, nota mesatare e studimeve parauniversitare për të gjitha vitet e shkollës së mesme duhet të jetë mbi 9, ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit. Pra në këtë rast, VKM-ja, në përputhje me kërkesat e ligjit është kujdesur të përcaktojë që standarti i të qenit student i shkëlqyer të përcaktohet sipas kriterëve të vendosura në rang kombëtar dhe jo sipas standarteve të vendit ku nxënësi ka kryer studimet parauniversitare.

Komisioneri vlerëson se, Komisioni Përzgjedhës i Fondit të Ekselencës, nuk bën thjesht vlerësimin e përmbushjes së kriterëve në rastin e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë ose të dytë të studimeve jashtë vendit, por ai në thelb kryen një proces të ekuivalentimit/konvertimit të notës mesatare.

Referuar procesverbalit nr.5, datë 28.08.2018, të mbajtur nga Komisioni Përzgjedhës, në kuadër të procedurave të Fondit të Ekselencës për vitin akademik 2018-2019, rezulton se, për rastin e kandidatës J.H, për të arritur në konkluzionin se kjo aplikante plotëson kriterin e mestares të kërkuar nga VKM nr.483/2014, Komisioni Përzgjedhës (KP), ka kryer këtë vlerësim:

Aplikantja J.H ka aplikuar për studimet e ciklit të dytë “Master”, në programin e studimit “Management”, në Cambridge University, Mbretëri e Bashkuar. Kjo aplikante rezulton të ketë përfunduar studimet e integruara, me mesatare 67.94/100 në Manchester University, në Mbretërinë e Bashkuar, në programin e studimit “Master of Pharmacy” në Manchester

University, në Mbretërinë e Bashkuar. Referuar VKM nr.483/2014, shkronja “vi”, studentët të cilët aplikojnë për mbështetje financiare nga programi i fondit të ekselencës, në ciklin e dytë të studimeve universitare, duhet të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9 për shkencat natyrore dhe teknike, për sistemin anglez të vlerësimit, KP ka dakortësuar se, grade A, përfshin rezultatin 70-100, vlerësimi më i lartë dhe 60 e sipër, i konsideron B, ekuivalente me 8 për studentët e ndërmjetëm. KP nuk ka ekuivalentuar më parë mesataren 9 dhe nuk ka përcaktuar një kufi rezultati.

Fillimisht KP, në lidhje me këtë aplikante ka arritur në konkluzionin se, për sistemin angez të vlerësimit, grade A përfshin rezultatin 70-100, vlerësimi më i lartë dhe është ekuivalent me notën 9-10 në sistemin shqiptar të vlerësimit, dhe për rrjedhojë studentja J.H nuk kualifikohet për mbështetje financiare nga programi i Fondit të Ekselencës sipas VKM nr.483/2014, pasi ajo nuk plotëson kriterin e notës mestare të kërkuar, e cila duhet të jetë mbi 9, për shkencat natyrore teknike.

Më pas, në një moment të dytë, Komisioni Përzgjedhës, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga Sekretariati Teknik i Programit, ka arritur në përfundimin se, nga transkripti i notave, ky sekretariat ka konstatuar se Universiteti i Manchesterit e klasifikon studenten me mesataren “First Class”, duke i përlllogaritur pesataren e ponderuar 70.11. Referuar procesverbalit, rezulton se pavarësisht se (ri) llogaritja e mesatares së aplikantes J.H është bërë nga universiteti që ka lëshuar diplomën, rezulton se përlllogaritja e mesatares së ponderuar është bërë sipas pikës 7, të kreut VII, të udhëzimit nr. 15, datë 04.04.2008, të MASR “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, ku përcaktohet se : *“Studentëve, në përfundim të programit të studimit, ju njehsohet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese”*.

Sa më sipër rezulton se, pretendimi i MASR se Komisioni Përzgjedhës ndër vite bazohet në klasifikimin që universitetet e huaja i bëjnë sistemit të tyre të vlerësimit, nuk rezulton i bazuar pasi në përlllogaritjen e mesatares së ponderuar për rastin e studentes J.H, edhe pse pretendohet se përlllogaritja është bërë nga universiteti i huaj që ka lëshuar diplomën, kriteret e përlllogaritjes së mesatares për këtë studente bazohen në kriteret kombëtare dhe në udhëzimin nr.15/2008, dhe jo sipas standartit të përcaktuar nga Mbretëria e Bashkuar, në rastin konkret.

Komisioneri, nuk mund të shqyrtojë në thelb se në cilën notë konvertohet apo ekuivalentohet nota mesatare e ankueses, por konstaton se mungesa e një procedure dhe kriterëve për mënyrën se notat apo rezultatet e fituara nga studentët në universitete jashtë vendit, e vendos kategorinë e studentëve që kanë një diplomë, certifikatë/titull të fituar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, në pozita më pak të favorshme. Kjo kategori në mungesë të një rregullimi ligjor, është gjithmonë në pasiguri juridike se si do të ekuivalentohet nota e fituar jashtë vendit, autoriteti përgjegjës apo procedura që ata duhet të ndjekin.

Në mungesë të një kuadri ligjor/nënligjor për mënyrën ose kriteret e ekuivalentimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja me sistemin shqiptar, MASR, pretendon se Komisioni Përzgjedhës ka ushtruar diskrecionin e tij, si një institucion i specializuar në këtë fushë, duke ruajtur të njëjtin standart vlerësimi për të gjithë kandidatët, por që në fakt në rastin e J.H nuk rezulton të ketë ndodhur.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesja e ka kundërshtuar në gjykatë vendimarrjen e Komisionit Përzgjedhës që nuk i ka njohur të drejtën për të përfituar nga mbështetja financiare për të vazhduar studimet jashtë vendit, një mundësi kjo që ofrohet në kuadër të parashikimeve të VKM nr.483/2014. Me vendimin nr.4165, datë 10.12.2019, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur të rrëzojë padinë e ankueses. Me vendimin nr.170, datë 16.03.2021, Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjykata ka vlerësuar të drejtë dhe të bazuar vendimarrjen e Komisionit Përzgjedhës në raport me ankuesen. Gjykata shprehet se: *“Gjykata Administrative e Apelit, në vlerësim të pushtetit diskrecionar të Komisionit Përzgjedhës, si organ i specializuar dhe kompetent sipas autorizimit të shprehur nga ligji, për të vlerësuar mbi kriteret përzgjedhëse të kandidatëve që aplikojnë për financimin e studimeve jashtë shtetit nga Fondi i Ekselencës i ngarkuar për të vlerësuar kriteret përzgjedhëse që bëjnë fitues një kandidat nga zbatimi i programit të Fondit të Ekselencës, çon të drejtë analizën e kryer nga gjykata e shkallës së parë se: “Pushteti i kontrollit të gjykatës mbi këtë vendimarrje gjithmonë shkon në proporcion me pushtetin diskrecionar të organit publik. Gjykata verifikon elementët me karakter objektiv dhe çmon provat në këtë spektër pikërisht për të vlerësuar faktin objekt verifikimi. Në gjykim nuk ka asnjë provë e cila të identifikojë një pushtet diskrecionar jo të ligjshëm të palës së paditur në raport me vendimarrjen e saj.”*

Në thelb, me këtë vendim, gjykata ka disponuar midis po atyre palëve dhe për të njëjtat pretendime, që ankuesja ka bërë objekt shqyrtimi pranë komisionerit. Vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe si i tillë ai është i detyrueshëm jo vetëm për palët por për çdo institucion tjetër. Ndodhur në këto kushte, pavarësisht konstatimeve dhe vlerësimeve të mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk mund të arrijë në përfundimin se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm për shkak se për të njëjtat palë, për të njëjtin objekt dhe të njëjtat veprime dhe mosveprime Gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë.

Duke ju rikthyer elementëve të nevojshëm për të konstatuar ekzistencën e diskriminimit, rezulton se, për të ngritur një pretendim diskriminimi duhet që në radhë të parë të provohet se ankuesja i është nënshtruar një trajtim të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm. Sa më sipër, gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi se më gjithë dyshimet e Komisionerit mbi bazën ligjore dhe praktikën e Komisionit, nuk mund të konstatojë dot trajtim të pabarabrtë pasi Gjykata ka vlerësuar se veprimet e Komisionit Përzgjedhës, të MASR, janë të ligjshme dhe të drejta.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e për rrjedhojë nuk është diskriminuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuseses R..S, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Gjuha, shtetësia, gjendja arsimore, vendbanimi.
Fusha: Arsim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim